

## **“Tarracat e Gjelbra”, Tirana Bank kontribuon në gjelbërimin e kryeqytetit.**

Tirana Bank ndër vite ka ndërmarrë fushata konkrete me qëllim përmirësimin e mjedisit dhe të cilësisë së jetës së komunitetit si: fushatat për një mjedis të pastër dhe zgjerimin e hapësirave të gjelbra, rritjen e ndërgjegjësimit ndaj ndryshimeve klimaterike, ndërtimin e këndeve të reja të lojërave etj., duke theksuar rëndësinë e zbatimit të politikave të përgjegjësive sociale dhe veçanërisht atyre mjedisore.

Ne besojmë që të gjithë aktorët e qytetit, duke përfshirë institucionet publike dhe bizneset private, duhet të mbeten të angazhuar për konkretizimin e Politikave të Përgjegjësive Sociale në shërbim të komunitetit dhe të mjedisit.

Sot, Tirana Bank inauguroi projektin më të fundit “Tarracat e Gjelbra”. Iniciativa për të promovuar një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër solli një tjetër bashkëpunim të suksesshëm me Bashkinë e Tiranës. Në aktivitetin e Inaugurimit ishin të pranishëm Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Tirana Bank, Z. Dritan Mustafa dhe Nënkrjetarja e Bashkisë së Tiranës, Znj. Anuela Ristani.

Në fjalën e tij përshëndetëse Z. Dritan Mustafa, shprehu se “Zgjerimi i zonave të banuara dhe i infrastrukturës së qytetit të Tiranës kërkon vëmendje të veçantë në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së jetesës dhe ambjentit. Kjo është një përgjegjësi me natyrë sa individuale aq edhe kolektive. Përkushtimin tonë ndaj mjedisit dhe gjelbërimit të qytetit, e shprehim nëpërmjet projekteve me natyrë simbolike, por me standarte etike dhe sociale të larta, si një vlerë të integruar në filozofinë e aktivitetit të Tirana Bank”.

Znj. Ristani falenderoi Tirana Bank për vëmendjen e treguar ndaj projekteve me impakt të lartë në komunitet : “Jam mirënjohëse që Tirana Bank, nëpërmjet projekteve të përgjegjësive sociale ka bërë të mundur që të realizojmë këto ide përbashkëta, në dukje të vogla por të rëndësishme dhe me impakt për qytetin”.

Tirana Bank mbetet e angazhuar të ofrojë kontributin e saj ndaj mjedisit dhe komunitetit, duke i qëndruar besnike vlerave dhe parimeve të Politikave të Përgjegjësive Sociale.

Tirana Bank, Këtu për Mjedisin!

